

OCT  
25

## Në “Loyola-Gymnasium” në Prizren, u përmbyllën punimet e Konferencës Kombëtare



Pas dy ditësh punë dhe aktivitete të ndryshme, i përmbylli të shtunën punimet Konferenca Kombëtare e Mësimdhënësve të Gjuhës Gjermane. Konferenca mbahet një herë në vit dhe deri më tani është mbajtur në Shqipëri, ndërsa kësaj radhe, për herë të parë u

organizua në Kosovë, në ALG “Loyola- Gymnasium”, në Prizren, në këtë gjimnaz gjerman me traditë 10- vjeçare në Kosovë, që tashmë përveç rezultateve të larta në procesin edukativo- arsimor, po bëhet qendër edhe e organizimeve të ndryshme arsimore e kulturore në Kosovë.

Pjesëmarrës në këtë Konferencë, përveç mësimdhënësve dhe profesorëve nga Kosova e Shqipëria, ishin edhe zyrtarë

të lartë, si ambasadorja e Republikës së Gjermanisë në Kosovë, zonja Angelika Viets, e cila u mahnit me ambientet e shkollës dhe me arritshmërinë e nxënësve të “Loyola-Gymnasium”, përfaqësues nga Ministria e Arsimit e Shqipërisë, Ministria e Arsimit e Austrisë etj.

Në hapje të Konferencës, ambasadorja Viets tha se ndjehet e lumtur që në Kosovë dhe Shqipëri është numër i madh i atyre që e kuptojnë dhe flasin gjuhën gjermane dhe se njohja e kësaj gjuhe pa dyshim se krijon shumë mundësi që në të ardhmen qytetarët nga Kosova e Shqipëria të studiojnë në Gjermani, e pse jo edhe të punojnë. Ne do të përkrahim të gjitha ato institucione të cilat mundësojnë përdorimin e metodave adekuate për mësimin e gjuhës gjermane edhe në të ardhmen, theksoi ambasadorja Viets.

Jonida Peza, drejtuese e Shoqatës së Mësimdhënësve të Gjuhës Gjermane në Shqipëri tha se qëllimi i Konferencës ishte bashkimi i mësimdhënësve të gjuhës gjermane dhe akterëve tjerë përmes këtij seminary dhe perspektiva e gjuhës gjermane. Poashtu ajo nënvizoi organizimin e mirë të Konferencës dhe kushtet e jashtëzakonshme në ambientet e gjimnazit “Loyola”.

Seminari u vlerësua i suksesshëm edhe nga Herbert Mühlfeit, drejtues i shoqatës së degës dugjuhësore në gjimnazin “Sami Frashëri” në Tiranë, Petra Behlke-Campos, drejtoreshë e Qendrës së Gjermanishtes në Tiranë, Norber Habelt, përfaqësues nga Ministria e Arsimit të Austrisë, Adnan Kraja, përfaqësues nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë etj.



Konferenca kaloi mirë dhe kishte rëndësi të veçantë, pasi që ishte një mundësi e mirë e shkëmbimit të ideve dhe praktikave të mësimdhënies së gjuhës gjermane. Ne si nikoqirë jemi shumë të kënaqur që mundëm të kontribuonim në mbarëvajtjen e mirëfilltë të kësaj konference, falë edhe hapësirave të shkollës, tha Neki Jahaj, drejtues i aktivitetit të mësimdhënësve të gjuhës gjermane në “Loyola- Gymnasium”. Ai, poashtu shprehu kënaqësi të veçantë që aktivi i gjuhës gjermane në këtë shkollë, përveç që është bërë tanimë pjesë e komunitetit të mësimdhënësve të gjuhës gjermane dha kontribut të veçantë në mbarëvajtjen e kësaj Konference.